

Leja e drejtimit

Për të drejtuar një makinë ose motoçikletë në Zvicër, leja e drejtimit është e detyrueshme. Kur të zhvendoseni në Zvicër, leja juaj e huaj e drejtimit duhet të ndërrohet me një zvicerane.

Leja e huaj e drejtimit

Kur të zhvendoseni në Zvicër, nëse tashmë keni një leje drejtimi, duhet ta ndërroni atë me një zvicerane. Keni 12 muaj për ta bërë këtë. Ju duhet ta paraqisni kërkesën tuaj në Office cantonal des véhicules (Zyrën Kantonale të Automjeteve, OVJ).

Në varësi të vendit nga vini, mund të keni kushte që duhet të plotësoni për të marrë lejen zvicerane të drejtimit. Mund t'ju duhet të jepni një provim teorik dhe/ose praktik. Office cantonal des véhicules (Zyra Kantonale e Automjeteve, OVJ) ju ofron të gjitha informacionet e nevojshme mbi këtë temë.

Provimi teorik i drejtimit të automjetit

Nëse dëshironi të merrni lejen tuaj praktike të drejtimit, së pari duhet të kaloni një provim teorik. Do t'ju duhet t'u përgjigjeni pyetjeve.

Në kantonin Jura, provimi teorik mund të jepet në frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe anglisht. Office cantonal des véhicules (Zyra Kantonale e Automjeteve, OVJ) ju ofron të gjitha informacionet.

Provimi praktik i drejtimit të automjetit

Pasi të keni kaluar provimin teorik, merrni një leje mësimi. Është e këshillueshme që të merrni mësim drejtimi me një instruktor profesionist. Instruktori do t'ju tregojë kur jeni gati për të dhënë provimin praktik të drejtimit të automjetit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/levizshmeria/leja-e-drejtimit